



## **INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH PSSA**

### **Cilat shkolla marrin pjesë?**

Të gjitha shkollat e Drejtorisë Arsimore (publike dhe Charter) marrin pjesë në testimet e vlerësimit. Shkollat jo-publike dhe private gjithashtu mund të marrin pjesë mbi baza vullnetare.

### **Cilët nxënës i nënshtrohen këtij vlerësimi?**

Me përjashtim të pak nxënësve, që përmbushin disa kritere specifike, të gjithë nxënësit do të përfshihen në këto vlerësime si më poshtë: ELA & Matematikë – Klasat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 Shkencë – Klasat 4 dhe 8

### **Kush vendos se çfarë duhet të vlerësojë ky testim?**

Grupe mësuesish nga të gjitha nivelet e arsimit në Pensilvani zgjedhin fushat e njohurive mbi të cilat do të bazohen këto vlerësime. Në këto grupe u përfshihen mësues, metodistë, drejtues të kurikulës dhe specialistë të kolegjeve. Ata gjithashtu rishikuan, redaktuan dhe aprovuan pyetjet e testit.

### **Kush i administron testimet për këto vlerësime?**

Çdo shkollë zgjedh personin(at) e vet, të cilët do të administrojnë testin. Në shumicën e rasteve, këta janë mësuesit e shkollës.

### **Si bëhet raportimi i rezultateve?**

Dy kopje të raporteve individuale të të gjitha testeve të çdo nxënësi dërgohen në drejtorinë arsimore dhe shkollat çarter për t'ju shpërndarë prindërve, mësuesve, këshilltarëve udhëheqës të këtyre testeve, si edhe/ose drejtorëve. Shteti nuk merr ndonjë raport me emrat e individëve pjesëmarrës në testet e vlerësimit.

Rezultatet në bazë shkolle raportohen sipas shkollave, për arsye të analizave të planeve dhe programeve mësimore. Drejtorinë arsimore dhe shkollat çarter mund të botojnë rezultatet e vlerësimit të testit PSSA për secilën shkollë. Shteti gjithashtu nxjerr të dhënat e vlerësimeve për çdo shkollë.

### **A mund t'i shikojnë prindërit përmbajtjen e vlerësimeve?**

Po, por vetëm nën një rrethanë. Shkollat hartojnë politika që, prindërit dhe kujdestarët kanë të drejtë të shikojnë testet e shtetit në mjediset e shkollës, në orare të përshtatëshme, duke planifikuar një takim së paku dy javë më përpara me koordinatorin e vlerësimeve të shkollës, për të përcaktuar nëse këto teste janë në konflikt me besimet e tyre fetare. Kjo është arsyeja e vetme nën të cilat lejohet rishikimi i testeve. Kopje të vlerësimeve ose shënimeve rreth pyetjeve nuk lejohet të dalin jashtë shkolle pa leje dhe gjithashtu midis palëve nënshkruhet një marrëveshje besimi. Nëse, pasi është bërë rishikimi i vlerësimeve, prindërit gjejnë që në teste ka konflikt me besimin e tyre fetar dhe duan që fëmija i tyre të justifikohet në mos pjesëmarrjen në test, ata mund të dërgojnë një shënim me shkrim Superintendentit, Shefit Egzekutiv të Shkollës Charter, ose Drejtorit të AVTS., ku paraqiten arsyet e mospjesëmarrjes në teste.

### **Raportimi i Parregullive në Teste**

Prindërit/kujdestarët të cilët besojnë se kanë gjetur parregullsi në teste, mund të telefonojnë në 844-418-1651 ose me email: ra-ed-pssa-kesytone@pa.gov për këto parregullsi.

## **INFORMACION RRETH TESTIMEVE NE GJUHEN ANGLEZE (klasat 3-8)**

### **Sa është kohëzgjatja e këtyre testeve?**

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndët e gjuhës Angleze është afërsisht nga tre deri në katër orë. Drejtoria arsimore duhet t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre vlerësimeve.

### **Çfarë përfshihet në testet e vlerësimit?**

Çdo nxënësi përfundon katër seksione me pyetje për secilin testim në lëndën e Anglishtes. Disa nga këto seksione me pyetje do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa seksione do të konsistojnë me grupe pyetjesh të ndryshme.

### **Çfarë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?**

Nxënësit u përgjigjen tre lloje pyetjesh: përgjigja në shumë variante (*multiple choice*), përgjigje me zgjedhje (*selected-response*) dhe pyetje që kërkojnë zhvillim/shpjegim (*constructed-response*). Në pyetjet me shumë variante, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura. Pyetjet me zgjedhje të përgjigjes, kanë dy pjesë dhe nxënësit zgjedhin një ose më shumë përgjigje për secilën pjesë, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të shpjegojnë përgjigjet e tyre. Këto përfshijnë pyetjen me përgjigje të shkurtëra në lexim (vetëm klasa e 3) dhe pyetje analitike në vartësi të tekstit (klasat e 4-8). Përgjigjet me zhvillim, përgjithësisht kërkojnë që nxënësit të kompozojnë përgjigjen në një prej tre mënyrave (tregimtare (klasat 3-8), spjeguese/informuese (klasat 3-8), sipas opinionit në klasat 3-5, ose argumentuese në klasat 6-8) Përgjigjet e shkurtëra kërkojnë nga nxënësit të hartojnë një përgjigje të shkurtër, ndërsa për pyetjet e analizës së një teksti, nxënësit analizojnë një tekst dhe përdorin fakte nga pjesa e lexuar për kompozimin e një eseje.

### **Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?**

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndën e gjuhës bëhet nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi profesional vlerësimit të ELA\_s, të paracaktuar më parë. Në përgjigjet e shkurtëra të pyetjeve, vlerësimi bëhet vetëm mbi bazën e përmbajtjes. Drejtëshkrimi dhe shenjat e pikësimit nuk përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit. Për testet e shkrimit, pikët përcaktohen përmes vlerësimit në aftësitë e kompozimit, si edhe të konvencioneve. Përgjigjet e pyetjeve të analizës së tekstit, vlerësohen nga përmbajtja dhe aftësitë e të shkruajturit.

### **Çfarë është vlerësimi në Arti i Gjuhës Angleze?**

Vlerësimi në gjuhën Angleze adreson gjashtë kategori të mëdha si edhe dy lloje tekstesh. Nxënësit përgjigjen veçmas në çeshtjet që japin vlerësim për përvetësimin e gjuhës dhe të shkrimit. Në vazhdim, vlerësimi në lëndën e leximit përfshin dy kategori kryesore që përmbledhin procesin e leximit. Nxënësit lexojnë një numër fragmentesh nga letërsia e mirëfilltë dhe ajo e informacionit dhe u përgjigjen pyetjeve rreth këtyre fragmenteve, prej nga ku nxënësit tregojnë aftësitë e tyre në leximin dhe kuptimin e fragmentit, si dhe në bërjen e analizave dhe interpretimin e teksteve të ndryshëm.

### **INFORMACION RRETH TESTIMEVE NË MATEMATIKË (klasat 3-8)**

#### **Sa është kohëzgjatja e këtyre testeve?**

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndën e Matematikës është afërsisht nga tre deri në katër orë. Drejtoria arsimore duhet t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre vlerësimeve.

#### **Çfarë përfshihet në testet e vlerësimit?**

Çdo nxënës përfundon tre seksione me pyetje për secilin testim në Matematikë. Disa nga këto seksione me pyetje do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa seksione do të konsistojnë me grupe pyetjesh të ndryshme.

#### **Çfarë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?**

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: përgjigja në shumë variante (*multiple choice*), përgjigje e hapur (*open-ended*). Në pyetjet me shumë variante, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura. Pyetjet me zgjedhje të përgjigjes, kanë dy pjesë dhe nxënësit zgjedhin një ose më shumë përgjigje për secilën pjesë, ndërsa pyetjet e hapura, përgjithësisht kërkojnë që nxënësit të kompozojnë përgjigjen duke dhënë detaje të hapave që ndërmarrin për zgjidhjen e problemit.

#### **Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet në Matematikë?**

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndën e Matematikës bëhen nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi vlerësimi të paracaktuar më parë. Në matematikë, pikët bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit nuk përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit.

#### **Çfarë vlerësohet në lëndën e matematikës?**

Vlerësimi në lëndën e matematikës përfshin pesë kategori të ndara në katër grupime kryesore. Proporcioni i pyetjeve në secilën kategori ndryshon sipas klasave/viteve. Si pjesë e vlerësimit të grupit A, *Numrat dhe Operacionet me numra*, nxënësit në klasat 4-8 u përgjigjen një seksioni të veçantë pyetjesh, në të cilën nuk lejohet përdorimi i kalkulatorit. Pyetjet që kërkojnë zhvillim/shpjegim, kërkojnë që nxënësit të tregojnë të gjithë punën matematikore (llogaritjet, grafikët, vizatimet e të tjera) dhe/ose të shpjegojnë me shkrim të gjithë rrugën e zgjidhjes së problemit.

### **INFORMACION RRETH TESTIMEVE NE SHKENCE (klasat 4 dhe 8)**

#### **Sa është kohëzgjatja e këtyre testeve?**

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndën e shkencës është afërsisht nga dy deri në katër orë. Drejtoria Arsimore do t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre testeve.

#### **Çfarë përfshihet në testet e vlerësimit?**

Nxënësit në klasat 4 dhe 8 plotësojnë dy seksione pyetjesh për vlerësimet në shkencë. Disa pjesë të testimit do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa do të përbëhen nga grupe të ndryshme pyetjesh.

#### **Çfarë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?**

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: pyetje me zgjedhje dhe pyetje që kërkojnë zhvillim/shpjegim. Në pyetjet me zgjedhje, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të kompozojnë përgjigjet e tyre. Për nxënësit e klasave 8, vlerësimi përfshin gjithashtu edhe skenarë shkencorë

#### **Çfarë është një skenar shkencor?**

Një skenar shkencor përfshin tekste, grafikë, diagrama dhe/ose tabela dhe i përdor këta elementë për përshkrimin e rezulttit të një projekti të klasës, një eksperimenti, ose një kërkimi të ngjashëm shkencor. Nxënësit përdorin informacionin e marrë në skenarin shkencor për përgjigjet e pyetjeve me zgjedhje.

#### **Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?**

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndën e shkencës bëhen nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi vlerësimi të paracaktuar më parë. Në shkencë, pikët bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit nuk përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit.

#### **Çfarë vlerësohet në lëndën e Shkencës?**

Testimi në shkencë adresohet në katër kategori kryesore: Natyra e Shkencës, Shkencat Biologjike, Shkencat Fizike dhe Shkencat e Tokës dhe Hapësirës. Proporcioni i pyetjeve të secilës kategori, ndryshon sipas nivelit të klasave.